

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Mars 2024


**Tiranë, më 25 Prill 2024:** Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Mars 2024, janë 1.150.442. Ky tregues rezulton me një rritje 35,9 %, krahasuar me Mars 2023. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2024, janë 1.175.710, duke shënuar një rritje me 39,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Hyrjet e shtetasve

Në Mars 2024, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 585.467. Ky numër është rritur me 26,6 %, krahasuar me Mars 2023.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 564.975. Ky numër është rritur me 47,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 (fig.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Mars 2023- Mars 2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 25/04/2024

### Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2024 janë 604.102. Krahasuar me Mars 2023, ky tregues është rritur me 30,6 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Mars 2024, janë 571.608. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues është rritur me 50,4 % (tab.1).

**Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Mars 2023	Mars 2024	Ndryshimi vjetor (%)	Janar - Mars 2023	Janar - Mars 2024	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje Gjithsej</b>	<b>846.645</b>	<b>1.150.442</b>	<b>35,9</b>	<b>2.375.341</b>	<b>3.161.751</b>	<b>33,1</b>
Shqiptarë	462.617	585.467	26,6	1.304.777	1.626.638	24,7
Të Huaj	384.028	564.975	47,1	1.070.564	1.535.113	43,4
<b>Dalje Gjithsej</b>	<b>842.428</b>	<b>1.175.710</b>	<b>39,6</b>	<b>2.490.382</b>	<b>3.396.175</b>	<b>36,4</b>
Shqiptarë	462.483	604.102	30,6	1.394.250	1.755.965	25,9
Të Huaj	379.945	571.608	50,4	1.096.132	1.640.210	49,6

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Mars 2024 rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 539.683 shtetas, pasuar nga Amerika dhe Azia Lindore dhe Paqësori, përkatësisht me 14.267 dhe 5.254 shtetas (tab.2).

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit**

Periudha	Mars 2023	Mars 2024	Janar - Mars 2023	Janar - Mars 2024
<b>Gjithsej</b>	<b>384.028</b>	<b>564.975</b>	<b>1.070.564</b>	<b>1.535.113</b>
I. Afrika	450	1.648	1.475	3.082
II. Amerika	8.952	14.267	22.253	31.281
III. Azia Lindore dhe Paqësori	2.183	5.254	4.854	10.390
IV. Lindja e Mesme	562	721	1.428	2.057
V. Azia e Jugut	842	2.344	1.816	3.892
VI. Evropa	369.935	539.683	1.036.249	1.474.946
- Evropa Qëndrore / Lindore	11.737	33.137	28.829	69.471
- Evropa Veriore	12.461	25.274	30.059	56.591
- Evropa Jugore	319.348	426.950	910.107	1.234.236
- Evropa Perëndimore	17.246	39.215	42.350	76.301
- Evropa Lindore / Mesdheut	9.143	15.107	24.904	38.347
VII. Rajone të paspecifikuara	1.104	1.058	2.489	9.465

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Mars 2024, krahasuar me Mars 2023, hyrjet e shtetasve të huaj shënojnë:

- rritje, për qëllime personale me 45,2 %;
- rritje, për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 44,7 %;
- rritje, për biznes dhe qëllime profesionale me 2,1 herë (tab.3).

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Mars 2023	Mars 2024	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 2023	Janar-Mars 2024	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje shtetas të huaj</b>	<b>384.028</b>	<b>564.975</b>	<b>47,1</b>	<b>1.070.564</b>	<b>1.535.113</b>	<b>43,4</b>
I. Personale	372.090	540.205	45,2	1.042.609	1.489.124	42,8
1. Pushime, vizitë tek të afërm. etj.	354.429	512.990	44,7	993.464	1.423.466	43,3
2. Trajtime shëndetësorë	25	70	180,0	180	179	-0,6
3. Qëllime fetare	22	55	150,0	80	98	22,5
4. Udhëtarë transit	17.614	27.090	53,8	48.885	65.381	33,7
II. Biznes dhe profesionale	11.938	24.770	107,5	27.955	45.989	64,5

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

## Përkufizime

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë), Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve, Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet:** Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë), Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës, Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

**Vizitor:** Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

*Qëllime personale* të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

*Kategoria e biznesit* që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm,

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm, Për më shumë referohu: [http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika\\_e\\_Revizionimit\\_Statistikor\\_](http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor_)

**Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:**

- Ligjit nr,71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.